



This project is funded  
by the European Union



## FONDI ECSORI – NËN GRANTET PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

### PYETJE DHE SQARIME

- 1. Duke parë dokumentat vura re se disa prej tyre janë në gjuhën angleze dhe disa në gjuhën shqipe, pyetja ime është, aplikimi duhet bërë në gjuhën angleze apo në gjuhën shqipe?**

Nëse aplikanti paraqet një propozim në vlerë deri në 10.000 Euro (LOT 1) (>5000 dhe <10,000), propozimi mund të paraqitet në gjuhën shqipe me një përmbledhje të projektit në gjuhën angleze, duke përdorur format e veçanta të përfshira në Shtojcën A.1 dhe A.2, B.1 dhe C.1.

Paketa shqip: [http://anttarc.org/.../open-call-for-proposals-announcement\\_.../](http://anttarc.org/.../open-call-for-proposals-announcement_.../)

Aplikantët për grantet 10,000-20,000 Euro (LOT 2) duhet t'a përgatisin dhe dorëzojnë aplikimin në gjuhën angleze.

Paketa anglisht: [http://anttarc.org/.../open-call-for-proposals-announcement\\_.../](http://anttarc.org/.../open-call-for-proposals-announcement_.../)

Për detaje ju lutem ndiqni me kujdes Udhëzimet për aplikantët: <http://anttarc.org/.../Annex-G.1-Udh%C3%ABzime-p%C3%ABr-Aplik...>

- 2. a) Është i ligjshëm aplikimi i një organizate me fokus barazinë gjinore dhe integrimin e gruas në proceset e zhvillimit të qëndrueshëm? Doja të pyesja a na penalizon fakti që nuk jemi organizatë që merret posacërisht me komunitetin Rom dhe Egjiptian për këtë grant? b) Qendra jonë nuk është e fokusuar pikërisht tek ky komunitet por në statutin tonë kemi si fushë veprimi integrimin social të grupeve të marginalizuara me fokusin tek femijët.**

Qëllimi i mbështetjes financiare të Grantit ECSORI është që OSHC-të që ofrojnë shërbime për komunitetin Rom dhe Egjiptian, të jenë të afta të zbatojnë projekte e iniciativa që promovojnë të drejtat dhe integrimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian në shoqëri. Fokusi i thirrjes për aplikime janë organizatat Rome dhe Egjiptiane dhe ato që i shërbejnë komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, por ne jemi të hapur për të gjitha organizatat që do të hartojnë një propozim ku argumentohet pse organizata ka kapacitete për të punuar me komunitetin Rom dhe Egjiptian dhe sesi konkretisht projekti do t'i vijë në ndihmë këtyre komuniteteve në zonën tuaj të veprimtarisë.

- 3. Ku mund të gjenden paketat e aplikimit në kuadër të thirrjes së hapur për aplikime?**

Paketat e aplikimit dhe dokumentin Udhëzime për Aplikantët mund t'i gjeni në faqen zyrtare të ANTTARC.

Autoriteti i Nën-Granteve:

Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC)



This project is funded  
by the European Union



Versioni në gjuhën angleze:

[http://anttarc.org/news/open-call-for-proposals-announcement\\_ecsori-fund/](http://anttarc.org/news/open-call-for-proposals-announcement_ecsori-fund/)

Versioni në gjuhën shqipe:

[http://anttarc.org/sq/news/open-call-for-proposals-announcement\\_ecsori-fund/](http://anttarc.org/sq/news/open-call-for-proposals-announcement_ecsori-fund/)

#### 4. A mund të aplikojnë në këtë thirrje individë?

Aplikantët potencialë për nën-grantet e Fondit ECSORI do të jenë aktorë nga shoqëria civile që punojnë në bashki të ndryshme në Shqipëri, përfshirë:

- OSHC-të Rome dhe Egjiptiane
- OSHC-të që punojnë me komunitetet Rome dhe Egjiptiane
- Të vendosura dhe që veprojnë në zonat ku jeton komuniteti Rom dhe Egjiptian.
- Të regjistruara në gjykatë (sipas ekstraktit nga gjykata, i tërhequr jo më parë se tre muaj nga data e aplikimit dhe Formularit të Entitetit Ligjor, shtojca D tek Udhëzimet, e plotësuar dhe e firmosur nga aplikanti).
- Të regjistruara në zyrën tatimore (me NIPT);
- Që nuk kanë detyrime financiare (si pas vërtetimit nga zyra tatimore).
- Që kanë llogari bankare të organizatës të vlefshme (treguar në Formularin e Identifikimit Financiar, Shtojces E tek Udhëzimet, certifikuar nga banka).

Iniciativat e aktorëve të shoqërisë civile të peregjistruara siç janë organizatat me bazë komunitare, grupet e qytetarëve dhe të rinjve, gazetarët lokal, aktivistët e shoqërisë civile do të mbështeten nëpërmjet organizatave të shoqërisë civile. Këta aktorë inkurajohen për të zhvilluar iniciativat e tyre përmes organizatave të formalizuara të shoqërisë civile.

#### 5. Ne jemi një organizatë e krijuar më 30/04/2018 dhe si e tillë edhe pse kemi aplikuar në shumë thirrje nuk kemi përfituar një grant pasi kërkohej gjithmonë minimalisht një vit funksionim si organizatë! Si e tillë, kërkojmë të dimë nëse mund të aplikojmë në thirrjen tuaj?

Në këtë thirrje nuk ka kriter për jetëgjatësinë e organizatës, por ne kërkojmë profilin e organizatës dhe CV të stafit që do angazhohet për projektin (ju lutem përmbajuni formës së aplikimit).

#### 6. Në thirrje shkruhet se mund të aplikojnë vetëm aktorë të shoqërisë civile që operojnë në bashki të Shqipërisë. Kjo vlen për institucionin apo për shtrirjen territoriale?

Autoriteti i Nën-Granteve:

Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC)



This project is funded  
by the European Union



Kur themi bashki të Shqipërise e kemi fjalën për shtrirje territoriale, pra në të gjithë Shqipërinë qofshin zona rurale dhe/ose urbane. Ndërkohë, Organizatat e Shoqërisë Civile potenciale duhet të jenë të vendosura dhe/ose të veprojnë në zonat ku jeton komuniteti Rom dhe Egjptian.

Autoriteti i Nën-Granteve:  
Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC)